



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr 3556/ prot
15

Datë, 23 / 07 /2018

VENDIM

Nr. 22 Datë 12 / 07 / 2018

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJEN E NJË PUS-SHPIMI, LAKNAS, NJËSIA
ADMINISTRATIVE KASHAR- TIRANË, PËR SUBJEKTIN INNOVEST SHPK, PËR
QËLLIME SANITARE

Në zbatim të Ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2; Vendimit Nr. 416 datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit nr.6 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

V E N D O S I :

1.Miratimin e lejes për hapjen e një pus shpimi me aktivitet në fushën e investimeve dhe ndërtimeve për qëllime sanitare (për hapjen e një shkollë 9-vjecare) ,për subjektin "Innovest"shpk me administrator Z.Klodjan Bregu nga shpuesi profesionist Hysni Hima , me adresë;Laknas njësia admisnitrative Kashar, bashkia Tiranë me këto të dhëna:

Koordinatat e grykës së pusit të projektuar: X=43 96 158 Y=45 80 833 Z=63 m

- Kapaciteti i parashikuar 0,1- 0,2 l/s
- Thellësia e shpimit të parashikuar 75 m
- Diametri i shpimit të pusit $\varnothing = 146$ mm
- Qëllimi i përdorimit: Ujë për përdorim sanitar

2.Ndjekja e pusit të bëhet nga specialistë hidrogeologë për izolimin e shtresës kuaternare

3. Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin e këtij vendimi

4. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR
Dorina ÇAPUNI



KRYETAR
Suzana JAHOLLAR

